



BASHKIA
TIRANË

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 42, datë 05.04.2017

PËR

“DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA ZJARRI PËR DISA FAMILJE QË BANOJNË NË TERRITORIN NËN JURIDIKSIONIN TË BASHKISË TIRANËS ”

Mbështetur në nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 shkronjat “a” dhe “b”; nenin 29 pika 1 dhe nenin 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 2 pika 3, nenit 16 dhe nenit 32 të Ligjit nr.8756, datë 26.03.2001 për “Emergjencat civile” (i ndryshuar); të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.329, datë 16.5.2012 për “Kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.84, datë 29.12.2016, për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017 – 2019 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2017” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Ti akordojë një ndihmë financiare familjeve të cilave iu është dëmtuar banesa dhe orënditë shtëpiake nga zjarri si më poshtë:
 - Kastriot Fallanaj, 705.105 (shtatëqind e pesë mijë e pesëqind e pesë) lekë.
 - Ilirjan Ruka, 1.170.000 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë.
 - Sadik Shera, 957.585 (nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë.
 - Selim Shera, 1.048.911 (një milion e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë) lekë.
 - Amarildo Nezha, është 1.638.162 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë.
 - Ramazan Elezi, 1.666.738 (një milion e gjashtëqind e e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë) lekë.
 - Floresha Krudo, 911.966 (nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

2. Efektet financiare të pikës 1 të këtij vendimi do të përballohen nga fondi i emergjencave i parashikuar në Buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2017.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile në Bashkinë e Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI